



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Përhershëm të Këshillit

Data e mbledhjes së Komisionit 26/01/2026

Ora e hapjes së mbledhjes 12:00

Marrin pjesë:

1. z. Altin Habip
2. znj. Ada Përmeti
3. z. Petrika Tollkuçi
4. znj. Mirela Qelesi

Marrin pjesë gjithashtu: Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Eva Naci sekretare e këshillit

Nga ekzekutivi marrin pjesë: Valbona Ziko, Marjana Jorgji.

Kryesuesi i mbledhjes është Petrika Tollkuçi

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej 4 Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit**: Nuk ka

Pikat e rendit të ditës.

1. **Projekt-vendim (Pika 8 e rendit të ditës) 8-** « **PËR MIRATIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE DHE PËRDORIMIN E TIJ NË BUXHETIN E VITIT 2026.** » propozuar nga ekzekutivi.
2. **Projekt-vendim (Pika 9 e rendit të ditës) 9-** « **PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR VITET 2027-2029.** » propozuar nga ekzekutivi.
3. **Projekt-vendim (Pika 10 e rendit të ditës) 10-** « **PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË NË VLERËN 641,850 LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “SHËRBIME SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË MOSHUARIT.”** » propozuar nga ekzekutivi.
4. **Projekt-vendim (Pika 11 e rendit të ditës) 11-** « **PËRMIRATIMIN E GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, ME BURIM FINANCIMI TË HUAJ NË VLERËN 1.111.093.19 LEKË** » propozuar nga ekzekutivi.
5. **Projekt-vendim (Pika 17 e rendit të ditës) 17-** « **PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 “TË KORÇA 2008” SH.A.** » propozuar nga ekzekutivi.
6. **Projekt-vendim (Pika 18 e rendit të ditës) 18-** « **PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKPIN E PARË DHE AKADEMINË “SKËNDERBEU” PËR VITIN 2026. Dhe PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E SKEMËS TË SHPËRBLIMEVE TË AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 TË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.** » propozuar nga ekzekutivi.

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimet

U sqaruan nga përfaqësuesit e administratës nevojat për projekt vendimet. U sqaruan projekt vendimet nga ana e përfaqësuesve të administratës.

Në lidhje me pikën 1, u kërkuar sqarim dhe u saktësua se kjo vlerë është kontributi i subjekteve të cilat ndërtojnë, në vlerën 3% të sipërfaqes së lehtë së ndërtimit për lehtë mbi 2.000 m², për objektet e banimit. Vlera e parashikuar është në nivelin 26.000.000 lek.

Për pikën 2, Parashikimi i të ardhurave në periudhën 2027-2029, janë parashikuar dhe përjashtimet nga tarifat për kategoritë e ndryshme. Rritja nga viti në vit është 1%.

Për pikën 3. Në kuadër të bashkëpunimit midis Bashkisë dhe Këshillit të Qarkut. Është menduar që ky fond do përdoret për shtimin e një punonjisi Social në shtëpinë e të moshuarve në lagjen 8.

Pika 4. Grandi i bazuar në bazë të performancës dhe vjen si kontribut i qeverisë Shqiptare dhe qeverisë Zviceriane. Ky fond do të përdoret për ndërhyrje në Bibliotekën Thimi Mitko dhe muzeu i fotografisë Gjon Mili.

Pika 5. Emërimi i audituesve ligjorë për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë.

Për pikën 6, Miratimi i trajtimeve ushqimorë dhe dietave për ekipin e I të Klubit Skënderbeu.

Emërimi i audituesve ligjor të pasqyrave financiare të vitit 2025 te Qendrës Sportive sh.a.

Mbyllet diskutimi

Përgatitet Vendimi i mbledhjes së Komisionit që do t'i paraqitet këshillit në seancë.

Vendimi i komisionit u përgatit nga sekretari i Komisionit

Lexohet Projekt-Vendimi i Komisionit nga kryetari

- **U votua Projekt vendimi sipas pikës 1 : PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.**
- **U votua Projekt vendimi sipas pikës 2 : PRO 3, KUNDER 0, ABSTENIM 1. Miratohet.**
- **U votua Projekt vendimi sipas pikës 3 : PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.**
- **U votua Projekt vendimi sipas pikës 4 : PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.**
- **U votua Projekt vendimi sipas pikës 5 : PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.**
- **U votua Projekt vendimi sipas pikës 6 : PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.**

Mbyllet mbledhja e Komisionit

Ora e mbylljes së mbledhjes : 12 : 45.

Nënshkruhet procesverbali i mbledhjes së komisionit

Kryetari i Komisionit

Sekretari i Komisionit



Këshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. ____ datë. 26/01/2026

Nr. ____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve, relacioneve dhe dokumentave shoqërues të projekt-vendimeve, në lidhje me propozimin

- **Projekt-vendim (Pika 8 e rendit të ditës) 8-« PËR MIRATIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE DHE PËRDORIMIN E TIJ NË BUXHETIN E VITIT 2026.»** propozuar nga ekzekutivi.
- **Projekt-vendim (Pika 9 e rendit të ditës) 9- “PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR VITET 2027-2029.”** propozuar nga ekzekutivi.
- **Projekt-vendim (Pika 10 e rendit të ditës) 10- “ PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË NË VLERËN 641,850 LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “ SHËRBIME SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË MOSHUARIT.”** propozuar nga ekzekutivi.
- **Projekt-vendim (Pika 11 e rendit të ditës) 11- “PËR MIRATIMIN E GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, ME BURIM FINANCIMI TË HUAJ NË VLERËN 1.111.093.19 LEKË”** propozuar nga ekzekutivi.
- **Projekt-vendim (Pika 17 e rendit të ditës) 17- “PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 “TË KORÇA 2008” SH.A.”** propozuar nga ekzekutivi.
- **Projekt-vendim (Pika 18 e rendit të ditës) 18- “ PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKIPI E PARË DHE AKADEMINË “SKËNDERBEU” PËR VITIN 2026. Dhe PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E SKEMËS TË SHPËRBLIMEVE TË AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 TË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.”** propozuar nga ekzekutivi.

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore e propozimit të projekt-vendimit dhe e vendimit të Komisionit të Përhershëm – a është i mbështetur në ligj propozimi dhe vendimarrja) ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe Ne zbatim të ligjit nr. 9936 date 26.6.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, të ligjit nr. 68 date 27.4.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", Udhezimit nr. 23 date 30. 7.2018 "Per procedurat standarte te pergatitjes se program it buxhetor afatmesem te njesive te veteqeverisjes vendore", i ndryshuar, udhezimit nr. 19 date 10.7.2025 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit – nëse konstatohet që ekziston nevoja për këtë vendim të propozuar dhe cfarë problematike zgjidh ai)

Për pikën 1 dhe 4: Kopetencë e Këshillit për miratimin e shtesave në Buxhet.

Për pikën 2: Kopetenca e këshillit si fazë e parë e hartimit të PBA 2027-2029.

Për pikën 3: Përmirësimi i shërbimeve sociale.

Për pikën 5 dhe 6: Këshilli ushtron kopetencën në cilësinë e pronarit të sh.a.-ve.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet – a ka efekte në buxhet dhe a është parashikuar ap nevojitet buxhet shtesë për zbatimin e vendimit)

Pika 1 dhe 4: Shtesa në buxhet për shkak të përcaktimeve ligjore.

Per piken 2 Parashikon gjithë situatën financiare të Bashkisë Korçë.

Pika 5 dhe 6: Nuk ka ndryshime në buxhetin e miratuar.

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin)

Kryetari I Bashkisë, Burimet njerëzore, sh.a.-të dhe Financat.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)

Kryetari I Bashkisë, Burimet njerëzore, sh.a.-të dhe Financat. Raportimi sipas afateve ligjore

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)

Pika 1 dhe 4. Ka efekt në buxhet dhe përfitojnë familjet në vështirësi strehimi dhe për investime.

Pika 2 ka përfitues shtresat sociale në nevojë për ndihmë socio psikologjike.

Pika 5 dhe 6 ka përfitues sh.a.të dhe kategorive të personave qe ju shërbejnë.

Pika 2. Banorët e Bashksië Korçë.

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015?)

Jo.

Komisioni i Përhershëm për “Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare”, i mbledhur me datën 15/12/2025, shqyrtoi projekt vendimet, relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet për:

1. *Projekt-vendim (Pika 8 e rendit të ditës) 8-« PËR MIRATIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE DHE PËRDORIMIN E TIJ NË BUXHETIN E VITIT 2026.” propozuar nga ekzekutivi.*
2. *Projekt-vendim (Pika 9 e rendit të ditës) 9- “PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR VITET 2027-2029.” propozuar nga ekzekutivi.*
3. *Projekt-vendim (Pika 10 e rendit të ditës) 10- “ PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË NË VLERËN 641,850 LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “ SHËRBIME SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË MOSHUARIT.” propozuar nga ekzekutivi.*
4. *Projekt-vendim (Pika 11 e rendit të ditës) 11- “PËR MIRATIMIN E GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, ME BURIM FINANCIMI TË HUAJ NË VLERËN 1.111.093.19 LEKË” propozuar nga ekzekutivi.*
5. *Projekt-vendim (Pika 17 e rendit të ditës) 17- “PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 “TË KORÇA 2008” SH.A.” propozuar nga ekzekutivi.*
6. *Projekt-vendim (Pika 18 e rendit të ditës) 18- “ PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKIPIN E PARË DHE AKADEMINË “SKËNDERBEU” PËR VITIN 2026. Dhe PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E SKEMËS TË SHPËRBLIMEVE TË AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 TË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.” propozuar nga ekzekutivi..*

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

- T'i propozojë Këshillit Bashkiak, miratimin e projektakteve.

Argumentat e vendimmarrjes janë paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Datë 26/01/2026